VENDIM
Nr.872, datë 22.12.2004

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË QYTETIN E KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private (tokë truall), i cili preket nga ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Kukësit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Kukësit.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për sipërfaqen 9665 m^2 tokë truall, me çmim 1159,1 lekë/m^2 e vlerësuar në shumën e përgjithshme 11 202 702 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e dy mijë e shtatëqind e dy) lekë.
4. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 240 000 (dyqind e dyzet mijë) lekë dhe të përballohet nga bashkia e Kukësit, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarit të shpronësuar.
6. Punimet të përfundojnë brenda muajit qershor të vitit 2005.
7. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit dhjetor 2004.

8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia e Kukësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano